

LIGJ
Nr. 16/2020

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9863, DATË 28.1.2008,
“PËR USHQIMIN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9863, datë 28.1.2008, “Për ushqimin”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj, emërtimet “ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”, “Autoriteti Kombëtar i Ushqimit” dhe “Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë” zëvendësohen përkatësisht me emërtimet “ministri përgjegjës për ushqimin”, “institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë” dhe “instituti përgjegjës për kryerjen e analizave të sigurisë ushqimore dhe veterinarisë”.

Neni 2

Në nenin 17, pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Shpenzimet për kontrollin zyrtar, marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave laboratorike përballohen nga importuesi.”.

Neni 3

Neni 21 shfuqizohet.

Neni 4

Në nenin 26, pika 7 ndryshohet si më poshtë:

“7. Përjashtime nga zbatimi i sistemit të vetëkontrollit, sipas pikës 1 të këtij neni, bëhen për prodhuesit e produkteve tradicionale, prodhuesit e sasive të vogla të produkteve primare, që furnizojnë direkt konsumatorin e fundit ose operatorë biznesi të prodhimit dhe të shitjes me pakicë direkt te konsumatori i fundit, nëse institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë, pas kontrollit të ushtruar, konfirmon se garantohej arritja e një niveli të pranueshëm higjienik, sipas praktikave të mira të prodhimit. Sasia e prodhimit dhe e shitjes, rrezja e tregtimit, kushtet dhe kriteret e miratimit të operatorëve të biznesit, që përjashtohen nga zbatimi i sistemit të vetëkontrollit, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për ushqimin.”.

Neni 5

Neni 31 shfuqizohet.

Neni 6

Në fund të nenit 38 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Tarifat për pajisjen me dokumentin që vërteton sigurinë e ushqimeve për eksport, marrjes së mostrave dhe analizimit të tyre, si dhe të kryerjes së kontrollit zyrtar në pikat e inspektimit kufitar miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Me përjashtim të rasteve të rregulluara me ligje të veçanta, llojet dhe normat e lejueshme lidhur me mbetjet e pesticideve dhe të medikamenteve veterinarë në ushqime, me përdorimin dhe pastërtinë e aditivëve ushqimorë, materialet në kontakt me ushqimin, kontaminuesit ushqimorë, enzimët, ushqimet për fëmijë, ekstraktet tretëse, ushqimet për përdorim me vlera ushqimore të caktuara, ushqimet me ngrirje të shpejtë, rrezatimet jonizuese, ujërat minerale, substancat pastruese, si dhe çdo substancë që destinohet të bëhet pjesë e ushqimit apo të jetë në kontakt me të, kërkesat thelbësore që duhet të përmbushin produkte të veçanta ushqimore, rregullat specifike të etiketimit për ushqime të veçanta, si dhe sëmundjet e transmetuara nga ushqimet, rregullat higjienike, sistemi i kontrollit në tregun e brendshëm, rregullat specifike për produktet ushqimore me origjinë shtazore, certifikimi i sistemit TRACES miratohen me udhëzime të ministrit përgjegjës për ushqimin.”.

Neni 7

Në nenin 45 bëhen ndryshimet mëposhtme:

1. Pika 2 shfuqizohet.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Laboratorët e autorizuar të kontrollit për kryerjen e veprimtarive bazë dhe të specializuara duhet të përmbushin kushtet e përcaktuara në praktikat e mira laboratorike, sipas parimeve të përcaktuara nga OECD-ja dhe legjislacioni i BE-së.”.

Neni 8

Në fund të nenit 61, pas pikës 9 shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“10. Marrëdhëniet e punësimit të punonjësve dhe të inspektorëve të institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Punës.”.

Neni 9

Neni 70 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 70

Procedura e kundërvajtjes administrative

1. Inspektori i institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë shqyrton shkeljet, sipas këtij ligji, dhe merr vendim përfundimtar në vendin e inspektimit. Vendimi përfundimtar është pjesë e procesverbalit dhe mbahet në vendin e inspektimit dhe i njoftohet, pa vonesë, subjektit të inspektimit. Nëse përfundimi i procesverbalit, përfshirë vendimin përfundimtar, në vendin e inspektimit nuk është i mundur, ai përfundohet në zyrat e

institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë dhe i njoftohet subjektit të inspektuar, brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të inspektimit.

2. Kur institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë kërkon ndihmë, për shkak të zbatimit të detyrës së ngarkuar me ligj, ajo mbështetet nga Policia e Shtetit dhe strukturat e tjera shtetërore të doganave dhe tatimeve.

3. Procedura e konstatimit, vendosjes dhe ankimit të masave administrative bëhet në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative dhe inspektimin.

4. Të ardhurat nga vjelja e gjobave derdhen 100 për qind në buxhetin e shtetit.”.

Neni 10

Pas nenit 70 shtohet neni 70/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 70/1

Shqyrtimi i ankimit të masave administrative

1. Për shqyrtimin e ankesave ndaj masave administrative të marra nga inspektorët e institucionit përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe të ushqimit për kafshë, gjatë kryerjes së një inspektimi, me vlerë të përgjithshme mbi 300 000 lekë, në ministri ngrihet Komisioni për Shqyrtimin e Masave Administrative, në përbërje të të cilit janë pesë anëtarë, tre përfaqësues të ministrisë dhe dy përfaqësues nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë.

2. Procedurat e organizimit dhe të funksionimit të komisioneve të shqyrtimit të masave administrative, përfshirë kryesimin, sekretariatit, ndryshimin e anëtarëve dhe masën e shpërblimit të Komisionit për Shqyrtimin e Masave Administrative përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 11

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 6 dhe 10 të tij.

2. Ngarkohet ministri përgjegjës për ushqimin që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 4 dhe 6 të tij.

Neni 12

Dispozita kalimtare

Ankesat për gjobat mbi 300 000 lekë, deri në ditën që hyn në fuqi vendimi i Këshillit të Ministrave për funksionimin dhe organizimin e Komisionit për Shqyrtimin e Masave Administrative në ministri, bëhen pranë komisionit të ankesave në AKU dhe përfundojnë shqyrtimin në këtë komision.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 12.2.2020.

Shpallur me dekretin nr. 11446, datë 4.3.2020 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta.